



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL, PEJË

I. Numër: 400-01/25106, datë: 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, më propozim të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi (DBPH) dhe kryetarit të Komunës, merr:

**VENDIM
Nr. 35/2025**

për buxhetimin e bashkëfinancimit të projektit “Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës” në mes të Komunës së Pejës dhe participimit të fermerëve/bujqëve përfitues

1. **MIRATOHET** propozimi i DBPH-së dhe Kryetarit të Komunës së Pejës, për buxhetimin nga bashkëfinancimi për projektin “Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës”, në mes të Komunës së Pejës më 70% dhe participimit nga fermerët/bujqit përfitues më 30%.
2. Në kuadër të projektit të lartëcekur, Komuna e Pejës dhe fermeri përfitues do të participojnë më kontribut financiar në shumën **166,950.00€** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro) ose 70% + 30% (Komuna Pejë me 116,865.00€ dhe Fermeret Përfitues me 50,085.00€).
3. Në total vlera e projektit është **166,950.00€** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro). Projekt ky dpalësh që financohet nga: Komuna e Pejës më 70% dhe participimi nga fermerët/bujqit përfitues më 30%.
4. Shuma e mjeteve **116,865.00€** nga Komuna e Pejës sipas këtij vendimi do të participohen nga Buxheti Komunal Pejë, Kodi Subvencione nga DBPH.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Drejtorinë për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

6. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.



Vendimi ti dërgohet:

*MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DBPH,
DBF,
Arkivës.*